



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1314 prot
110

Durrës, më 19.07. 2019

VENDIM

Nr 49 , datë 19.07 2019

"Miratimin e pagesës së orëve mësimore të realizuara mbi mësimdhënien e normuar vjetore, për vitin akademik 2018 -2019 nga personeli akademik me kohë të plotë i gjashtë fakulteteve të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës"

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 109/2017 "Për buxhetin e shtetit, për vitin 2018", vendimit nr. 1, datë 08.01.2018 të Bordit të Administrimit "Për miratimin e detajimit të grantit 2018", Vendim nr. 268, datë 29.3.2017, për disa ndryshime në Vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë" të ndryshuar, , Udhezimi nr.29, date 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 19.07.2019,

VENDOSI:

1. Miratimin e pagesës në masën deri në 200 orë mësimore të lejueshme mbinormë për vitin akademik 20178-2019 nga personeli akademik me kohë të plotë i gjashtë fakulteteve të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës", sipas udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë".
2. Pagesa e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi do të bëhet:
 - a) Brenda muajit gusht 2019 do të paguhet 100 orë suplementare të lejueshme sipas udhëzimit të realizuara nga cdo anëtar i personelit akademik me kohë te plotë.
 - b) Pjesa e mbetur do të paguhet sipas disponibilitetit të universitetit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

Administratori
Drejtorja e Administrimit Financiar

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar i Bordit të Administrimit

Ilirjana NANO

